

**Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit****Nr.07/351-02-5345****Dt.28.03.2017**

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së aplikuesit: **Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim - Komuna Gjakovë**, për dhënjen e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të banimit individual – shtëpisë familjare për familjet e zhvendosura në Mal të Zi të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me etazhitet P+1, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. I LEJOHET aplikuesit: Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Gjakovës, ndërtimi i objektit të banimit individual – shtëpi familjare, me vërejtjet e poshtëshënuara, për familjet e zhvendosura në Mal të Zi të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Detal Urbanistik “Mulliri i Gutave”, Kushtet Ndërtimore, me nr. 07-351-02-1554, dt.28.02.2017, të lëshuara nga DUMM, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 4273/2, Z.K. Gjakovë –J- Qytet, në rrugën “Mithat Frashëri” në pronësi të Afrim (Halim) Neziraj, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është P+1, me sipërfaqe të përgjithshme të objektit,  $S = 75 \text{ m}^2$ .**

**Përdhesa:** (Sip bruto ) .....  $S = 37.5 \text{ m}^2$   
**Kati i parë:** (Sip bruto) .....  $S = 37.5 \text{ m}^2$

**Vërejtje: Leja Ndërtimore ipet me vërejtje, ashtu që, investitori duhet ta rrespektojë strikt lokacionin e dhënë, për arsye të distancës minimale prej 1.0m, e cila nuk lejon hapje të mëdha të dritareve, dhe njëkohësisht objekti duhet të pozicionohet sipas lokacionit të dhënë.**

**II.** Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit të banimit individual nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë Organizata “Developing Together “ Prishtinë.

**III.** Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

**IV.** Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organi mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së pak 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve;

**V.** Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

## Arsyetim

**Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Gjakovës**, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351-02/1554 të datës 26.01.2017 për dhënjen e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të banimit individual – shtëpisë familjare, për familjet e zhvendosura në Mal të Zi, të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me etazhitet P+1, në ngastrën ndërtimore me nr. 4273/2, Gjakovë-J Qytet, siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 24.02.2017, të punuar nga: DUMM"- Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 30.11.2016 (fotokopje) në pronësi të Psh Kuvendi i Komunës Gjakovë nga Gjakova, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikata mbi të drejtën në pronën e paluajtshme(fotokopje) me nr.të lëndës 2004/16, të datës 30.11.2016, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Memorandum i Mirëkuptimit me nr. 01-415-45483, dt.01.07.2016, 0', nr,2144/3 dt.31.03.2017, nr.proces 5, për 'Eu Kthimi dhe Ri-integrimi në Kosovë faza e IV'(EU-RRK IV) ndërmjet Organizatës Ndërkombëtarepër Migrim (IOM), Ministrisë për Komunitete dhe kthim (MKK) dhe Komunës së Gjakovës.
5. Kushtet Ndërtimore, ME NR.07-351-02/1554, dt. 28.02.2017, për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objekteve të banimit individual në ngastrën kadastrale me nr. 4273/2, Z.K: Gjakovë-J Qytet .
6. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, me Vërejtjet e lartëcekura, të datës 14.03.2017.
7. Pëlqimin nga K.R.U."Radoniqi"Sh.A.-Gjakovë,të datës 13.03.2017.
8. Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, të datës 07.03.2017.
9. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, Organizata "Developing Together " Prishtinë.

I liruar nga taksa administrative, në bazë Nenit 5, paragrafi 5.15. nënparagrafi b), të Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa nga Shërbimet Komunale, me nr. 01 Nr.011-43964/2015, dt.30.06.2015.

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi,pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor në Prishtinë, dhe e nejtja dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit ,
- Arhivës,

Zyrtar i lartë për çështje juridike

Zenel Shabani,jur.dipl.

Drejtoria  
Elida Bejtullahu, inxh.s dipl.e ark.






Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY


KOPJA E PLANIT \ KOPIJA PLANA \ COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija \ Municipal Cadastral Office : GJAKOVË  
Zona Kadastrale / Katastarska Zona \ Cadastral Zone : Gjakovë J. Qytet

Njësia \ Jedinica \ Unit	Tipi \ Vrsta \ Type	Sipërfaqja \ Poveršina \ Area m <sup>2</sup>
P - 70705028 - 04273 - 2	Parcelë \ Parcela \ Parcel - oborr	432.0
	Parcelë \ Parcela \ Parcel -shtëpia	118.0



Shkalla / Razmera /Scale: 1:500

Punoi \ Obradio \ Created :  
Data \ Data \ Date : 30.11.2016  
Koha \ Vreme \ Time : 15:25:17  
Nënshkrimi \ Potpis \ Signature:   
Shënim \ Beleška \ Note :

Aprovoi \ Usvojio \ Approved: Drejtori \ Direktor \ Director  
Nënshkrimi \ Potpis \ Signature: 